



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Kom.Dh.Shk.II.nr.365/24

GJYKATA KOMERCIALE – Dhomat e Shkallës së Dytë, gjyqtari Faton Bajrami, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Kompania Rajonale e Ujësjetës Bifurkacioni Sh.A., me seli në Ferizaj, rr. “Enver Topalli”, kundër debitorit Komuna e Ferizajit- Shkolla Fillore e Mesme e Ulët Bilall Shala, me seli në Ferizaj, rr. “Kosinë”, sipas dokumentit të besueshëm përmbarimor, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit dhe debitorit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë KPPP.nr.2022/22 të datës 14.06.2023, me datën 05.06.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHEN si të pathemeltë ankesat e debitorit Komuna e Ferizajit- Shkolla Fillore e Mesme e Ulët Bilall Shala dhe kreditorit Kompania Rajonale e Ujësjetës Bifurkacioni Sh.A., me seli në Ferizaj, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë KPPP.nr.2022/22 të datës 14.06.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, me aktvendimin KPPP.nr.2022/22 të datës 14.06.2023, në pikën I të dispozitiv, e ka aprovuar pjesërisht prapësimin e debitorit Komuna e Ferizajit- Shkolla Fillore e Mesme e Ulët Bilall Shala, me seli në Ferizaj dhe ka anuluar pjesërisht P.nr.76/22 i datës 15.02.2022, të përmbaruesit privat Bardh Tasholli, me seli në Ferizaj, për pjesën e detyrimi prej 7,641.84 euro për periudhën kohore 30.04.2015 e deri me datën 31.01.2019, në pikën II mbetet në fuqi pjesa tjetër e urdhëri përmbarimor P.nr.76/22 i datës 15.02.2022 të përmbaruesit privat Bardh Tasholli sa i përket shumën prej 584.19 euro, për periudhën kohore 28.02.2019 e deri me datën 31.01.2022 dhe në pikën III ka përfunduar pjesërisht procedurën përmbarimore të kreditorit Kompania Rajonale e Ujësjetës Bifurkacioni Sh.A., me seli në Ferizaj, ndaj debitorit Komuna e Ferizajit- Shkolla Fillore e Mesme e Ulët Bilall Shala, sipas urdhëri përmbarimore P.nr. 76/22 i datës 15.02.2022, për shumën prej 7,641.84 euro.

Kundër aktvendimit të lartcekur, brenda afatit ligjor, ankesë ka parashtruar kreditori, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe për shkak të zbatimit të gabuar të drejtës materiale, si dhe për shpenzimet e procedurës me propozimin që të aprovohet ankesa e kreditorit, të anulohet Aktvendimi KPPP.nr.2022/22 të datës 14.06.2023 dhe të mbetet në fuqi propozimi për përmbarim.

Po ashtu edhe debitori ka paraqitur ankesë për shkak të rishqyrtimit të faturave për periudhën 2015-2018, me propozim që të rishikohet borxhi pasi që shumat janë enorme nga këto fatura dhe të pa përballeshme për debitorin.

Kreditori nuk ka ushtruar përgjigje në ankesën e debitorit.

Gjykatës Komerciale - Dhomat e shkallës së Dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) dhe gjeti se:

Ankesat e debitorit dhe kreditorit janë të pathemelta.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori me datën 15.02.2022, ka paraqitur propozim për përmbartim ndaj debitorit në bazë të dokumentit të besueshëm – ekstraktit të verifikuar të librave afarist me shifër K026496, që në afat prej 7 ditësh të paguaj për shumën e borxhit prej 8,226.03€, si dhe të gjitha shpenzimet të procedurës e përmbartimit.

Përmbartuesit privat Bardh Tasholli, me seli në Ferizaj, me seli në Prishtinë, duke vepruar sipas propozimit për përmbartim të kreditorit ka lëshuar urdhër me të cilin ka lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit të besueshëm– ekstraktit të verifikuar të librave afarist me shifër K026496, e cilat paraqet dokument përmbartuese në bazë të nenit 29 par.1.2 të LPP-së.

Kundër urdhrorit për lejimin e përmbartimit, brenda afatit ligjor, debitori ka paraqitur prapësim, duke theksuar se dokumenti i besueshëm në bazë të së cilës është lejuar përmbartimi nuk është real pasi që brenda periudhës kohore kreditori nuk ka lexuar njehsorët në kohën reale, pasi që në disa periudha është faturuar vetëm tarifa kryesore, gjithashtu shumën e borxhit të cilën kërkohet është parashkruar, andaj i ka propozuar. Andaj ka propozuar që ta pranoj prapësimin e debitorit dhe të anuloj urdhërin përmbartimor dhe të obligoj kreditorin që ti bartë shpenzimet e procedurës përmbartimore.

Kreditori ka paraqitur përgjigje në prapësim, duke theksuar se prapësimi i debitorit është i pa bazuar me asnjë prove dhe dokumenti përmbartë të gjitha elementet e një dokumenti të besueshëm, gjithashtu debitori nuk kundërshton borxhin akumuluar, andaj ka propozuar që të mbetet në fuqi urdhëri përmbartimor.

Lidhur me prapësimin, Gjykata Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, me aktvendimin KPPP.nr.2022/22 të datës 14.06.2023, në pikën I të dispozitiv, e ka aprovuar pjesërisht prapësimin e debitorit Komuna e Ferizajit- Shkolla Fillore e Mesme e Ulët Bilall Shala, me seli në Ferizaj dhe ka anuluar pjesërisht P.nr.76/22 i datës 15.02.2022, të përmbartuesit privat Bardh Tasholli, me seli në Ferizaj, për pjesën e detyrimi prej 7,641.84 euro për periudhën kohore 30.04.2015 e deri me datën 31.01.2019, në pikën II mbetet në fuqi pjesa tjetër e urdhëri përmbartimor P.nr.76/22 i datës 15.02.2022 të përmbartuesit privat Bardh Tasholli sa i përket shumën prej 584.19 euro, për periudhën kohore 28.02.2019 e deri me datën 31.01.2022 dhe në pikën III ka përfunduar pjesërisht procedurën përmbartimore të kreditorit Kompania Rajonale e Ujësjetllësit Bifurkacioni Sh.A., me seli në Ferizaj, ndaj debitorit Komuna e Ferizajit- Shkolla Fillore e Mesme e Ulët Bilall Shala, sipas urdhëri përmbartimore P.nr. 76/22 i datës 15.02.2022, për shumën prej 7,641.84 euro.

Gjykata Komerciale - Dhomat e Shkallës së Dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka marr aktvendimin e saj të drejtë dhe të bazuar në dispozitat e procedurës përmbartimore. Gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka konstatuar se në shkresat e lëndës konstatohet se pretendimet në prapësim janë pjesërisht të qëndrueshëm, sepse i plotëson kushtet ligjore në kuptim të nenit 29 dhe 37 të LPP-së. 4 të LPP-së, rrjedhimisht nuk janë përmbushur asnjë nga kushtet ligjore për anulimin e urdhërit të përmbartimit të përcaktuar me nenin 69 dhe 71 të LPP-së. Vlen të ceket se sipas vlerësimit të gjykatës, vlerëson se pretendimet e debitorit në prapësim, sa i përket detyrimin disa janë të paqëndrueshme, andaj të njëjtin e aprovoi pjesërisht.

Po ashtu, Kjo gjykatë vlerëson se nga shkresat e lëndës se Gjykata e shkallës së parë drejt ka vendosur si në pikën I të dispozitivit, ku sa i duke aprovuar pjesërisht si të bazuar prapësimin e debitorit, për pjesën e detyrimi prej datës 30.04.2015 e deri me datën 31.01.2019 në shumë prej 7,641.84 euro, ngase këtu kemi të bëjmë e parashkrim sipas nenit 355 të LMD-së, sepse urdhëri përmbartimor është ushtruar me datën 15.02.2022, ndërsa për secilën kërkes nga paraqitja e kreditorit të cekura më lartë kanë kaluar më tepër se 3(tri) vite nga koha e arritjes për pagesë. Ndërsa në pikën II të dispozitivit, ka lënë fuqi pjesën tjetër të urdhrit P.nr.76/22 i datës 15.02.2022, për shumën në vlerë prej 584.19 € për periudhën kohore 28.02.2019 e deri me datën 31.03.2021, për faktin se është e bazuar dhe nuk kemi të bëjmë me parashkrim të borxhit referuar nenit 355 par.1 të LMD-së ku parashihet se *“Kërkesat reciproke nga kontratat komerciale si dhe kërkesat e shpërblimit të shpenzimeve të bëra lidhur me këto kontrata, parashkruhen për tri (3) vite”*, ndërsa sipas para.2 të këtij nenit përcaktohet se *“Parashkrimi rrjedh veç e veç për çdo dërgim të mallit, pune ose shërbimi të krye”*, pra për faktin se urdhëri përmbartimor është ushtruar me datën 15.02.2022, pra brenda periudhës 3(tri) vjeçare, dhe në pikën III të dispozitivit, ka vendosur në bazë të nenin 12 të LPP-së, ku përcaktohet se *“Në rast se e aprovon prapësimin, gjykata varësisht nga rrethanat e rastit e përfundon përmbartimin në tërësi ose pjesërisht dhe i anulon veprimet e kryera.”*, duke përfunduar pjesërisht procedurën përmbartimor. Prandaj, Gjykata e shkallës së parë drejt ka vepruar kur prapësimin e debitorit e ka aprovuar pjesërisht, i ushtruar kundër urdhrit përmbartimor P.nr.76/22 i datës 15.02.2022.

Gjykata Komerciale – Dhomat e shkallës së dytë i vlerësoi edhe pretendimet ankimore të palës kreditore, mirëpo të njëjtat i refuzuar si të pabazuar dhe të pa mbështetura në shkresat e lëndës.

Së këndejmi, Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vlerësuar gjendjen faktike dhe nuk ka vepruar me shkelje të dispozitave me rastin e vendosjes si në aktvendimin e atakuar.

Nga arsyet e paraqitura me lartë, gjykata e shkallës së dytë vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi në pajtim me nenin 208 dhe 209 pika b) të LPK-së, e lidhur me nenin 17 dhe 77 të LPP-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e shkallës së dytë

Kom.Dh.shk.II.nr.365/24, me datë 05.06.2024

**Gjyqtari,
Faton Bajrami d.v.**